



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2121

NR. VENDIMI 3917



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. Akti 2121

Nr. Vendimi 3917

Datë regjistrimi 04 shtator 2015

Datë vendimi 10 maj 2016

V E N D I M
" NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Gjykata e Rrethit Gjyqësore Tiranë me trup gjykues të përbërë nga :

Rezarta MATAJ ----- Gjyqtare

me sekretare seance Elona Molla, në Tiranë, sot më datë 10 maj 2016, ora 14:30 pasi mori në shqyrtim në disa seanca të veprimeve përgatitore me dyer të hapura çështjen civile që i përket :

Paditës: *Shoqëria "***" sha me NUIS ** me adresë në **, me administrator ** i cili përfaqësohet në gjykim me autorizim nga av. **, antarë e Dhomës së Avokatisë Tiranë.*

I paditur: *** me NUIS ** me adresë në ***, i mbrojtur në gjykim nga av. *** antare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.*

Me person të tretë: *Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave e përfaqësuar nga juriste ***.*

Me objekt: *1. Konstatimin e konkurrencës së pandershme si pasojë e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare *** nga pala e paditur subjekti *** Ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare *** në qarkullimin tregtar nga *** Demshperblimin nga përdorimi i pa autorizuar i markës dhe demi moral, prishjen e reputacionit në masen *** leqë .*

Baza ligjore: *Neni 348 i Kodit të Procedurës Civile, neni 638, 639*

të Kodit Civil, ligji nr. 9947/2008 2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, neni 156 e

vijues.

-Në bisedimet përfundimtare pala paditëse kërkoi: "Pranimin e kërkesë padisë, sipas objektit dhe pagimin e shpenzimeve avokature duke paraqitur edhe faturën tatimore për shërbimin".

-Pala e paditur *** dhe av. *** u shprehën: "Rrëzimin e padisë".

- Personi i tretë Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe e Patentave u shpreh: "E lë në çmim të gjykatës".

-Gjykata pasi mbylli hetimin gjyqësori, konsultoi çështjen në ligj, prova dhe bindjen e saj të brëndshme

VËRËN se

1. Paditësi *** i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (më tej GJRRGJ Tiranë) me kërkesë-padinë me palë të paditur *** objekt, shkak ligjor si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Gjykata sipas nenit 348 të Kodit të Procedurës Civile (më tej KPRC) vlerëson se ka juridiksionin gjyqësor, kompetencën tokësore dhe lëndore në gjykimin e kësaj kërkesë-padie pasi është seksioni tregtar i kësaj Gjykate e cila gjykon të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale për tërë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Sipas nenit 35 të KPRC kjo çështje gjykohej nga një gjyqtar pasi vlera e objektit të padisë është nën 20 milion lekë.

II. Mbi faktet dhe rrethanat e çështjes të provuara në gjykim

4. Paditësi është krijuar me 02 shkurt 1995 dhe është regjistruar me dtë 01 shkurt 2001. Ka fushë të veprimtarisë së saj improt eksport, përpunim argjendi, ari, unaza, varëse, medaljonë, zinxhirë, vathë etj. Prodhim të suvenirëve me bakër, argjend, të lara në ar ose argjend, punim medalje. Vëndi ku e ushtron veprimtarinë është Tiranë *** etj. Emri tregtar është " ***".

5. Pala e paditur është krijuar me datë 04 tetor 2010, me adresë tek *** dhe me veprimtari tregti me pakicë të suvenirëve.

6. Me apikimin e datës 05 mars 2014 rezulton se paditësi ka regjistruar markën me nr. ***, me afat vlefshmërie deri më 05 mars 2044 emër "PIRRO" dhe logo me një shqiponjë mbi emrin PIRRO dhe poshtë emrit nën vizë është logo diamanti e cila ndan emrin ARTISTIC DHE JEWELLERY, të cilat nuk janë të mbrojtur si emra të përgjithshëm.

7. Si listë e mallrave dhe e shërbimeve që përdoren kjo logo sipas klasifikimit ndërkombëtar të Nicë janë metalet e çmuara, argjendari dhe gurë të çmuar, orë me metar dhe material të çmuar, varëse, unaza, spilla, perla, kuti bizhuterisë, medalione, flori, fije argjendi, butona këmishash etj.

8. Nga kërimi i bërë në DPPM nuk rezulton se *** si person fizik të ketë regjistruar markë apo logon e saj që nga data e regjistrimit të tij si tregtar e deri më tani.

9. Sipas shpjegimeve të paditëses, rezulton se në vëndin ku ushtron pala e paditur veprimtarinë në rrugën e ***, ka vendosur një tabelë (shih fotot të administruara në dosje) me sfond të verdhe dhe me shkronja kapitale PIRRO dhe në vertikalisht në një kolonë të dyqanit ka shënimin PIRRO SOUVENIR. Në vitrinën hyrëse ka souvenir të ndryshme bakëri, porcelani, druri dhe bluza, flamuj me element kombëtar shqiptar etj.

10. Në dyqanin ku paditësi tregton është një tabelë e zezë me emrin PIRRO dhe me logon e njëjtë si ajo e regjistruar si markë me shqiponjë, diamant etj. Po ashtu paditësi paraqiti edhe foto të sendeve që ai tregtonte kryesisht punime argjendi, skulptura me personazhe si Nënë Tereza etj.

11. Nga klientë të ndryshëm, paditësi është vënë në dijeni se në rrugën e *** ka edhe një dyqan tjetër suvenirësh Pirro. Pasi ka bërë verifikimet paditësi ka konstatuar tabelën me emrin Pirro dhe me tregtim të të njëjtave mallra që ai ka regjistruar markën dhe tregton mallrat në veprimtarinë e tij tregtare. Për këtë i ka bërë një kërkesë për zgjidhje me pajtim të çështjes me datë 25 maj 2015 ndërsa me 12 qershor 2015 i ka kthyer përgjigje se nuk e pranonte këtë ofertë dhe se këtë emër e ka pasuar nga shitësi i mëparshëm i aktivitetit që quhej Pirro dhe nuk ka shkelje ligjore.

12. Në këto kushte paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

13. Gjatë gjykimit i padituri pranoi se është për ta zgjidhur çështjen me pajtim dhe për ta hequr tabelën ku lexon Pirro por nga ana tjetër këtë ftesë për marrëveshje Paditësi edhe pse gjykata i dërgoi kërkesën për pajtim qëndroi në heshtje ndërsa avokatja u shpreh se jemi për zgjidhje deri në fund të gjykimit.

14. Paditësi paraqiti edhe kontrata të bërë për efekt reklamimi me televizione të ndryshme kombëtare për të ngritur reputacionin dhe për të sqaruar më tej konsumatorët mbi logon e tij, mallrat që tregton etj. Kontratë e datës 18 shtator 2015 me TV *** për shitje kupash, kontratë 2015 mes Pirro shpk dhe *** në Vorë për një vit për efekt reklamash në shumën *** euro/muaj, kontratë shërbimi në vitin 2014, muaji prill mes Paditësit dhe gazetës *** në shumën *** euro/muaj, kontratë reklamimi mes Paditësit dhe *** në shumën *** euro datë 24 janar 2014, pagesa të paditësit për media *** në shumën *** euro në atë 21 janar 2014 etj.

15. i padituri u shpreh se nuk kemi markë të njëjtë pasi shkrimi nuk rezulton identik, malli nuk është i njëjtë, adresa nuk është e njëjtë, nuk provohet se i kanë rënë shitjet, tabela me emrin PIRRO është prej 18 vjetësh dhe paditësi ka disa vite që është regjistruar si markë.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

16. Kodi Civil i ndryshuar.

Neni 638 -Konkurrenca e pandershme

“Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që:

1. përdor emrat ose shënjjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;

2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;

3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmerisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.”

Neni 639

“Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcaqton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat.

Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë

dëmin.”

Neni 608 -Përgjegjësia për shkakëtimin e dëmit

“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakuar.

Personi që ka shkakuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

“Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkakuar.”

“Në një kontratë, shkak i ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme”.

17. Ligji 9947 datë 07 korrik 2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar

Neni 156 -Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

“1. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

2. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:

a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;

b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare;

c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës.

3. Në përputhje me pikën 2 të këtij neni, gjithashtu, ndalohet:

a) vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre;

b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime;

c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë;

ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë;

d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

4. Të drejtat, që i njihen pronarit të markës së regjistruar, sipas këtij neni, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “ç” të pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji. “

Neni 184/a E drejta për të vepruar kundër shkeljes së të drejtave

“ 1. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave, sipas këtij ligji, i përket: a) pronarit të një patente, disenoje ose markë të regjistruar;”

Neni 184/b Procedurat në rast shkeljeje

“1. Personat e përmendur në nenin 184/a, të këtij ligji, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tyre për të kërkuar: a) ndalimin e veprimeve të mëtejshme që përbëjnë shkelje të të drejtave; b) heqjen ose bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave nga qarkullimi civil ose shkatërrimin e këtyre objekteve; c) heqjen ose bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për krijimin apo prodhimin e produkteve, që përbëjnë shkelje ose shkatërrimin e tyre; ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.

2. Gjykata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”, të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveç kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”, gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat e palëve të treta.

3. Masa e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, mund të merret edhe ndaj një ndërmjetësi, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur një të drejtë të pronësisë industriale.

4. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë, brenda tre vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin.”

Neni 184/c Shpërblimi i dëmeve

“Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit.

Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos për masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe.

Gjykata, në caktimin e masës së dëmshpërblimit: a) mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, përfshirë edhe fitimin e munguar, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi, si rezultat i konkurrencës së pandershme dhe, sipas rastit, edhe dëmin moral shkakuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja, cenimin e emrit apo të reputacionit të tij tregtar etj.; b) sipas rastit, mund të vendosë shpërblimin e menjëhershëm të dëmit duke llogaritur fitimet që do të siguroheshin ose do të merreshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë industriale në fjalë.”

IV. Vlerësimi dhe analiza e çështjes sipas ligjit dhe provave

18. Përgjegjësia jashtëkontraktore për shkak të konkurrencës së pandershme është e lidhur ngushtësisht me mbrojtien që njeh personi nga ligji për të pronësinë industriale e shfaqur në formën e markave tregtare, dizenjove industriale, patentave etj.

19. Të konkurrosh në treg ekonomikisht do të thotë të “garosh” me të njëjtën “kundërshtar” që tregtojnë të njëjtët mallra apo shërbime në treg por duke qënë i hapur, duke zbatuar rregullat e tregut, ligjet e vendit pa krijuar një pozitë dominuese në disfavor të tjetrit nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme apo që bien ndesh me zakonet e mira tregtare. Neni

638 i KC Konkurrencën e pandershme e përkufizon kur:

1. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;

2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;

3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

20. Rezulton se paditësi ushtron veprimtarinë e tij në fushën e argjendarisë, import, eksport përpunim sendesh argjendi, ari por edhe prodhim suveniresh me bakër, argjend, ar etj. Për prodhimet e argjendit ai për këtë sende që tregton i shoqëron edhe me një shenjë, markën e së cilës ai e ka të regjistruar duke u bërë pronar i kësaj shenje dalluese e konkretisht bëhet fjalë për fjalën "PIRRO" me logon e shqiponjës, shenjën e diamantit dhe me një vizë, ndërsa emri Souvenir Jeelery nuk është e mbrojtur.

21. Mbrojtia e kësaj logo dhe emërtimi sipas regjistrimit nr. nr. *** është nga periudha 05 mars 2014 e deri më 05 mars 2024. Të drejtën e përdorimit të kësaj marke pra me pamje dhe me shkronja i ka efektet e regjistrimit që në momentin e aplikimit sipas nenit 146 të ligjit nr.9947/2008, ne rastin konkret që me datë 23 mars 2012.

22. Sipas nenit 156§2,b të ligjit në nr.9947/2008 për shkak të regjistrimit i pari të kësaj marke, pronari fiton pronësinë njësoj si mbi një send të luajtshtëm a të paluajtshtëm dhe ka të drejtë të ndaloj çdo person që përdor në ushtrim të veprimtarisë së tij tregtare shenjë të njëjtë a të ngjashme me markën e tij ku për shkak të njëllojshmërisë së shërbimit, konsumatori konfondohet.

22. Rezulton se pala e paditur ushtron veprimtari tregtare, kjo e provuar nga ekstrati historik i QKR-së ku është regjistruar me emrin tregtar ***, ka fushë veprimtaria tregtare të njëjtë si pala paditëse atë të tregtimit me pakicë të suvenireve. Edhe nga fotot në dyqanin e tij përballë ambasadës Jugosllave tek Rruga e *** Tiranë, ai ka një tabelë me emrin Pirro dhe më poshtë në mënyrë vertikale Pirro Souvenir ndërsa ngjitur është një dyqan tjetër me emrin ARGJENDARI e cila të jep përshtypjen se është vazhdim i tabelës Pirro (shih fotot në dosje). Nga vitrina ka sende të ndryshme bakri, argjendi, skulptura qeramik, druri, veshje etj.

23. Së pari- Gjykatë vlerëson e edhe një shtetas me intelekt mesatar do të konfondodet kur në treg të shikoj dyqanin e të paditurit *** me merin PIRRO, më poshtë Pirro Souvenir dhe po ashtu ngjitur dyer një dyqan me emrin ARGJENDARI që duket se i takon të njëjtit Pirro Argjendari. Emri i përdorur në dyqanin e të paditurit është identikë me emrin e mbrojtur tashmë nga ana e paditësit prandaj për gjykatën, pala paditëse me të drejtë legjitomohet të kërkoj nga i padituri cënim të markës tregtare dhe mospërdorim të mëtejshëm të saj. Kjo ngjashmëri vjen nga emri Pirro i cili katë njëjtat shkronja, shoqëron mallra të njëjtë a të njashëm si suvenire argjendi, bakër etj.

24. Së dyti - plotësohet edhe kushti i konkurrencës së pandershme se malli është i njëjtë dhe me logon e përdur njësoj dhe në një zonë afër me njëra tjetërën, rruga e Kavajës me rrugën e Durrësit në Tiranë.

25. Së treti- Për shkak të reklamimeve të shpeshta të Argjendari dhe Suvenire Pirro në televizione të ndryshme kombëtare shqiptare është evidente se pala e paditur ka përfituar nga marka me reputacion të njohur në Republikën e Shqipërisë dhe ka zgjedhur a mbaj

tabelën me emrin PIRRO për të konfonduar konsumatorin me një markë të mëparshme të mirënjohur dhe për të joshur ata se sendet që shiten aty janë të prodhuara nga Argjendari Pirro.

26. Si përfundim gjykata e gjen me vënd pretendimin e paditësit se kemi konkurrencë të pandershme nga pala e paditur mbi tregtimin e suvenireve me emrin në dyqan PIRRO dhe Pirro Souvenir. Po ashtu gjen të drejtë pretendimin e paditësit sipas nenit 639 të KC që të merren masa për zhdrukjen e kësaj konkurrence:

Detryrimin e palës së paditur personi fizik tregtar *** që të heq nga dyqani ku ushtron veprimtarinë tregtare tabelën me emërtimin "PIRRO".

Detryrimin e palës së paditur personi fizik tregtar *** që të ardhmen të mos përdor më emërtimin PIRRO si shenjë reklamuese, dalluese e veprimtarisë së tij tregtar dhe të suvenireve që ai tregon.

IV. Mbi shpërblimin e dëmit

27. Paditësi në referencë të nenit 638, 639 të KC në mënyrë alternative mund të shpërblej edhe dëmet që mund të ketë pësuar i konkurruari nga konkurrenca e pandershme.

29. Së pari për gjykatën konkurrenca e pandershme kërkon dashje direkte, qëllim të drejtëpërdrejtë për të ulur fitimet e palës konkurrenca dhe për të shtuar fitimet e tij.

30. Rezulton për gjykatën se nga veprimi i paligjshëm i përdorimit i një marke tregtare të regjistruar nga peresona të pautorizuar nga pronari bie në kundërshtim me nenin 156 të Ligjit nr. 99047/2008. Provohet se paditësi për emrin e fituar, reputacionin e krijuar ka investuar me kontrata reklaimi në disa televizione përkatëse, gazeta, faqe online etj. KY emër dhe reputacion është dëmtuar nga pala e paditur e cila jo vetëm e ka dëmtuar atë duke tregtuar sende të tjera që nuk i përfshin marka e paditësit por edhe duke ndarë me të klientelën dhe e ka konfonduar.

31. i padituri pranoi deri në seancën e fundit se e ka pasur tabelën aty dhe se nuk ka marrë ndonjë masë përtë treguar se është penduar apo e ka kryer këtë veprim nga neglizhenca etj. Përkundrazi me qëndrimin e tij mohues dhe pretendimin e paprovuar e këtë emër e ka trashëguar nga ish-pronari nuk e provoi në gjykim. Në këtë mënyrë për gjykatën u provua se i padituri ka vepruar me dashje dhe keqbesim. Ky element është i domosdoshëm në shpërblimin e dëmit për konkurrencën e pandershme sipas nenit 639 të KPRC. Pra termi faj nuk duhet interpretuar gjerësisht por vetëm në rastin kur kemi dashje direkte.

32. Pretendimin për dëm të pësuar nga paditësi në masën *** lekë gjykata nuk e gjen tërësisht të mbështetur. Për gjykatën është e qartë se mallrat që tregon paditësi si suvenire argjendi etj. me mallrat jo në nivelin e duhur nga cilësia (nisur nga fotot e paraqitura nga palët) që tregon i padituri kanë dëmtuar reputacionin dhe imazhin e paditësit.

33. Paditësi dështoi në provimin përpara gjyqtës se çfarë dëmi pasuror, ka pësuar " *** pra të shitjeve të rëna nga konkurrenca e pandershme me *** prandaj padia do të pranohet tërësisht vetëm për dëmin jopasuror të shkaktuar shoqërisë *** , kjo në masën *** lekë.

V. Mbi shpenzimet gjyqësore të çështjes

34. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore sipas nenit 106 të KPRC ngarkohen gjyqumbësit pra: "Taksat mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, në qoftë se ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së

padisë që është pranuar nga gjykata. ”

35. Gjykata konstaton se fatura tatimore e shitjes mes avokates dhe paditësit sipas ligjit për kontabilitetin është e nënshkruar dhe është i rregullt në shumën prej *** euro ose *** lekë. Po ashtu janë kryer shpenzime si taksa gjyqësore *** lekë për 1% e vlerës së padisë, *** fletëthirrje *** copa = *** lekë, shpenzime noteriale *** lekë, të cilët duhet të paguhen nga i paditur si gjyqumbës. Meqënëse padia nuk u pranua për tre kërkimet vetëm njëra nuk është pranuar tërësisht gjykata vlerëson se ato duhet të paguhen në masën ¼ nga i padituri.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126,306 -310,102-106 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenet 156 e vijues të ligjit nnr. 9947/2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar

V E N D O S i

Pranimin e pjesshëm të padisë të palës paditëse Shoqëria "**** me NUIS **** si e mbështetur në ligj dhe në prova ndaj palës së paditur *** me NUIS ****

Konstatimin e konkurrencës së pandershme të të paditurit *** ndaj palës paditëse *** pronare e markës tregtare me nr. *** datë regjistrimi 05 mars 2014 , në formën e pëdorimit të emërimit "Pirro" në aktivitetin e tij tregtar, dyqan suveniresh e ndodhur në rrugën e Durrësit, Pallati përbasllë ish-Ambasadës Jugosllave kati parë Tiranë.

Detyrimin e palës së paditur *** që të heq nga dyqani ku ushtron veprimtarinë tregtare tabelënë me emërtimin "PIRRO".

Detyrimin e palës së paditur *** që të ardhmen të mos përdor më emërtimin PIRRO si shenjë reklamuese, dalluese e veprimtarisë së tij tregtar dhe të suvenireve që ai tregton. Shpërblimin e palës paditëse *** në masën prej *** lekësh (****) lekë për dëmin jopasuror, në formën e dëmit moral të shkaktuar *** për përvetësim të markës tregtare, konfondim të konsumatorit dhe cënim të reputacionit të tij tregtar.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.

Bashkë me këtë vendim lëshohet urdhëri i ekzekutimit.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur në proporcion me pranimin e padisë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot me date 10 maj 2016!

Sekretare gjyqësore

Gjyqtare

Elona Molla

Rezarta MATAJ

SHPENZIMET GJYQËSORE
(Sipas neneve 102 dhe 106 të K. Pr. Civile)

Takë regjistrimi 1% *** Lekë
Takë aktesh noteriale *** Lekë
Për njoftime *** Lekë

TOTALI i SHPENZIMEVE: *** Lekë
(***)

Sekretarja Gjyqësore

Elona Molla